

## Vendim nr. 291 datë 27.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 39 (A) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **AKIL GRADECI**, përfaqësuar nga avokat Bujar Hoti, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-225 (31), datë 13.02.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**BAZA LIGJORE:** **Nenet 15, 18, 30, 33, 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, 141 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 paragrafi 1 dhe 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71, pika 1, 71/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 34 i ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë; nenet 4, 8/a, pika 2, 112, pika 3, 149, 152, 383, pika 1, shkronja “ç”, 388, pika 1, shkronja “d”, 390 pika 1, 432, 433, 434, 436/a dhe 440 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); nenet 25 dhe 78 të Kodit Penal (*KP*); vendimi nr. 67, datë 10.11.2017 i Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*);**

**vendim unifikues nr. 4/2021 i Kolegjeve të Bashkuara  
të Gjykatës së Lartë.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr.1845 të vitit 2015, mbi bazën e referimit të materialeve procedurale të dërguara nga Drejtoria e Policisë Vendore Shkodër, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 09.10.2015 në fshatin Stajkë të Bashkisë Vau i Dejës, ku një person, i identifikuar më pas si shtetasi L.Gj., është gjetur i vrarë me armë zjarri brenda një makine të rënë në kanal in e ujit në anën e majtë të rrugës Kryebushat - Mjedë. Gjatë hetimeve paraprake, pas grumbullimit të një sërë provash materiale, dokumentare, shkencore dhe deklarime të shtetasve, organi i ndjekjes penale ka identifikuar si autorë të veprës penale shtetasin E.H., në cilësinë e ekzekutorit dhe kërkuesin Akil Gradeci, në cilësinë e bashkëpunëtorit, duke e akuzuar këtë të fundit për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78, paragrafi 1 dhe 25 të KP-së, akuzë për të cilën është dërguar për gjykim.

2. Në përfundim të gjykimit të zhvilluar me procedurë të shkurtuar, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 32 (161), datë 16.01.2018, ndër të tjera, ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprën penale “Vrasja me paramendim”, të kryer në bashkëpunim, duke e dënua me 15 vjet burgim, dënim i cili është ulur me 1/3-ën në aplikim të nenit 406 të KPP-së dhe ai është dënua përfundimisht me 10 vjet burgim. Ajo gjykatë ka arsyetua se nga provat e marra në kuadër të procedimit penal vërtetohet te j çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprën penale që akuzohet, ndërsa ka ndihmuar autorin kryesor E.H. në organizimin e planit kriminal dhe ka marrë pjesë aktive në realizimin e tij, duke pritur e ndjekur viktimën dhe shoqëruar autorin kryesor deri në realizimin e veprës penale. Nga ana tjetër, gjykata nuk e ka pranua si të vërtetë faktin e pretendua nga kërkuesi se ka qenë në banesën e tij dhe jo me autorin kryesor në momentin kur ka ndodhur vepra penale, me arsyetimin se nuk përputhej me provat e tjera të administruara në gjykim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, duke kërkua deklarimin e tij të pafajshëm. Po ashtu, ka paraqitur ankim edhe i

bashkëpandehuri E.H., duke kërkuar ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale në “Vrasje me dashje”, pa rrethanën e bashkëpunimit.

3. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 712, datë 16.07.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me fajësinë dhe cilësimin juridik të veprës penale për sa i përket të bashkëpandehurit E.H., ndërkohë që e ka ndryshuar vendimin në lidhje me kërkuetin dhe deklaruar atë fajtor për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së, duke e dënuar me 3 vjet burgim, dënim i cili është ulur me 1/3-ën në aplikim të nenit 406 të KPP-së dhe ai është dënuar përfundimisht me 2 vjet burgim. Gjykata e apelit e ka gjetur të saktë analizën e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me praninë e kërkuetit në të njëjtin mjet me autorin kryesor në momentin e vrasjes nga ky i fundit të viktimës L.Gj., por ky fakt, sipas saj, nuk provon bashkëpunimin mes tyre dhe kryerjen nga kërkueti të veprës penale që akuzohet, për sa kohë nuk provohet që kërkueti të ketë qenë në dijeni të planit kriminal të bashkëpandehurit tjetër E.H. dhe as që ai të ketë ndihmuar këtë të fundit në kryerjen e veprës penale, ndërkohë që çdo dyshim për akuzën shkon në favor të të pandehurit referuar nenit 30 të Kushtetutës dhe nenit 4 të KPP-së. Nga ana tjetër, sipas asaj gjykate, fakti që kërkueti, megjithëse ka pasur dijeni për veprën penale të kryer në prezencën e tij nga i pandehuri E.H., nuk e ka kallëzuar atë para organit të ndjekjes penale, e ngarkon atë me përgjegjësi për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, duke kërkuar prishjen e tij dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu kanë ushtruar rekurs edhe kërkueti, sikundër edhe i gjykuari tjetër E.H., të cilët kanë kërkuar kthimin e çështjes për rigjykim.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-225 (31), datë 13.02.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si gjykata e vetme aktualisht që ka kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e apeliemeve ndaj vendimeve të gjykatave të shkallës së parë. Sipas Gjykatës së Lartë, vendimi i gjykatës së apelit duhet të priset referuar pretendimit të ngritur në rekursin e prokurorit, për shkak të mosrespektimit të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pasi vendimi i gjykatës së apelit nuk përmbush standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të përcaktuar në nenin 112 të KPP-së, si garanci për procesin e rregullt ligjor. Konkretisht, sipas asaj gjykate, gjykata e apelit ka mangësi në arsyetim, duke mos arsyetuar në mënyrë shteruese në lidhje me justifikimin e vendimmarrjes së saj për atë pjesë të akuzës që bën fjalë për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim”, në bashkëpunim, prej dy të pandehurve, akuzë e cila, për më tepër, është gjetur e bazuar nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata e apelit, vijon ajo, ka

anashkaluar parashtrimin e motiveve të faktit dhe të së drejtës mbi të cilat ka mbështetur vendimin e saj, si dhe të arsyeve për të cilat i quan të papranueshme provat e kundërta, si detyrim i përcaktuar nga neni 383 i KPP-së. Nga ana tjetër, për sa u përket rekurseve të të gjykuarve, përfshirë edhe të kërkuesit, Gjykata e Lartë është shprehur se është në pamundësi për trajtimin e tyre në kushtet e verifikimit të pranueshmërisë së shkaqeve të rekursit të prokurorit dhe prishjes së vendimit të gjykatës së apelit e kthimit asaj të çështjes për rigjykim.

5. Në datën 03.09.2024, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatë, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 20.09.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

6.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

6.1.1. *Parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi gjykimi në dhomën e këshillimit, në mungesë të kushteve të kontradiktoritetit, përbën cenim të procesit të rregullt ligjor, ndërsa çështja, për shkak të problematikës ose kompleksitetit, duhet të shqyrtohej në seancë gjyqësore me praninë e palëve sipas nenit 437, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së.

6.1.2. *Parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës për ankim efektiv*, pasi gjykata e apelit në rigjykimin e çështjes nuk do të ketë mundësi të shqyrtojë pretendimet e mbrojtjes në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, kontradiktoritetit dhe analizës së provave, për sa kohë Gjykata e Lartë në vendimin e kundërshtuar ka konkluduar se bashkëpunimi mes dy të pandehurve ekziston, duke lënë detyrë për gjykatën e rigjykimin vetëm arsyetimin e këtij fakti. Vendimi i gjykatës së apelit në rigjykimin e çështjes, referuar neneve 440 dhe 448, pika 2, të KPP-së, do të mund të ankimohet vetëm për shkaqet që nuk lidhen me pikat e vendosura nga Gjykata e Lartë, ndaj nisur nga kjo kërkuesit i mohohet e drejta e ankimit efektiv në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, pasi vendimi i gjykatës së apelit nuk do të mund të ankimohet për sa i përket faktit të bashkëpunimit ndërmjet tij dhe të pandehurit E.H.

6.1.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi si gjykata e apelit ashtu edhe Gjykata e Lartë nuk kanë arsyetuar lidhur me pretendimet e kërkuesit, ndërsa kjo e fundit, në kundërshtim edhe me mendimin e këshilltarit ligjor

për mungesën e shkaqeve ligjore në të tria rekursët e paraqitura, ka shqyrtuar vetëm rekursin e prokurorit.

6.2. *Parimi i barazisë para ligjit dhe barazisë së armëve*, pasi rekursi i kërkuarit, në thelb, përmbante si shkak mungesën e arsytimit të vendimit të gjykatës së apelit, ndaj Gjykata e Lartë, në shqyrtim të rekurseve të paraqitura, nuk duhet të konkludonte për pjesëmarrjen ose jo të kërkuarit në ngjarjen për të cilën është akuzuar, qëndrim i cili veson rigjykimin e çështjes në apel.

6.3. *Parimi i prezumimit të pafajësisë*, pasi organi i akuzës e ka paragjykuar kërkuarin si fajtor, megjithëse asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar. Edhe Gjykata e Lartë e ka zhvilluar procesin me paragjykimin se kërkuari është bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale, pa analizuar asnjë pretendim të tij.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitetin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në rastin konkret Kolegji vlerëson se kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi gjyqësor i kundërshtuar prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ndaj ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë

Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprahe çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në vështrim të standardit kushtetues të elaboruar më sipër, Kolegji vëren se objekti i ankimit kushtetues individual është shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në ankimin e kërkuarit ngrihen pretendime qoftë për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, ashtu edhe për procesin e rishqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe vendimmarrjes eventuale të saj. Për sa u përket pretendimeve për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Kolegji vlerëson se vendimi i kësaj të fundit nuk përbën vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi nuk ka përmbyllur procesin gjyqësor lidhur me themelin e çështjes. Ndërsa për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin e rishqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit dhe vendimmarrjes eventuale të saj, Kolegji konstaton se për sa kohë procesi nuk ka përfunduar dhe, për më tepër, në të gjitha shkallët, kërkuari nuk mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual. Për rrjedhojë, kërkuari ka ende mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë. Kolegji çmon të evidentojë se garancitë e nenit 42 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për proces të rregullt ligjor vijnë të jenë të zbatueshme edhe në procesin gjyqësor të rigjyimit, sikundër për procesin në tërësi deri në përfundim të tij. Gjykata e apelit do të rishqyrtojë çështjen sipas urdhërimit të Gjykatës së Lartë brenda kufijve të shqyrtimit të çështjes prej saj (neni 425 i KPP-së), pra brenda shkaqeve të ngritura edhe në ankimin e kërkuarit, duke iu përmbajtur edhe vendimit të Gjykatës së Lartë për çështjet e së drejtës që është vendosur me të (neni 447 i KPP-së), që në rastin konkret konsiston në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor në drejtim të përmbushjes së elementeve që një vendim gjyqësor i arsyetuar duhet të përmbajë për të mos u konsideruar i pavlefshëm (nenet 112 dhe 383 të KPP-së).

11. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj në kushtet kur ky kriter paraparak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.